




REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dp. Dp.	Nr. Prot. Beprot. Prot No
2-D/DPK	01-2105/2012
Nr. ffaq Broj stranica Nr. pages	Datp. Datum Dat
02	13-06-2012



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika d)si dhe 29.3 të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 01.06.2012, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllët rasti me nr. AKK– 03-538/12,për, zyrtaren e Lartë znj.Teuta Haxhiu, Deputete e Kuvendit te Republikës se Kosovës, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm te interesit është zhvilluar procedura e parapare sipas nenit 18.2 te ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit te Interesit ne Ushtrimin e Funksionit Publik.

Pas informatës se marre nga një imell anonime ne adrës te AKK-së , ka filluar shqyrtimi i lendes me numër protokolli AKK–03-538/12, që për trajtim ka pasur Zyrtaren e Lartë, znj.Teuta Haxhiu Deputete e Kuvendit te Republikës se Kosovës

Gjate zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtarja e lartë, gjatë kohës se ushtrimit të funksionit publik si, Deputete e Kuvendit te Republikës se Kosovës,njëkohësisht ka qene duke punuar ne një pun tjetër si Mësuese ne Shkollën “Zef Prenkaj ne Sheremet të Gjakovës.

Agjencia kundër Korrupsionit me datën 30.03.2012, e ka njoftuar zyrtaren e Lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejte në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave, znj,Teuta Haxhiu, pasi ka kontaktuar me zyrtaret e Agjencisë ka kërkuar te takohemi dhe ti bisedojmë me gjendjen.

Zyrtaret e Agjencisë kanë shkuar të takohen me znj. Haxhiu dhe të ballafaqohen me faktet që posedon Agjencia, gjatë takimit që është mbajtur në zyrat e Kuvendit të Republikës së Kosovës është biseduar për gjendjen dhe faktet që disponon Agjencia lidhur me konfliktin e mundshëm të interesit, gjatë ushtrimit të funksionit Publik. znj. Teuta Haxhiu, i ka njoftuar zyrtaret e Agjencisë me detyrat dhe përgjegjësit e saj në funksionin si Deputete të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ku punon, si dhe me punën tjetër dytësore si Mësuese në Shkollën "Zef Prenkaj" në Sheremet të Gjakovës, e zgjedhur me konkursin publik. Ajo ndër të tjera ka theksuar se është e informuar dhe konsideron se nuk është në gjendje të Konfliktit të Interesit pasi që puna në lëmin e arsimit si punë sekondare që ajo ushtron nuk bie ndesh as me Ligjin për të Drejtat dhe Përgjegjësit të Deputetëve Nr. 03/L-111. Asë me Ligjin Nr. 04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

znj. Teuta Haxhiu Deputete e Kuvendit të Republikës së Kosovës ndër të tjera ka thënë se asnjë herë në asnjë moment gjatë kohës sa ushtron pozitën e Deputetes së Kuvendit të Republikës së Kosovës nuk ka qenë në pozitën që mund të sillte në situatë të konfliktit të Interesit dhe mund të kenë ndonjë lidhje me punën dytësore si Mësuese në Shkollën ku punon.

Me datën 15.05.2012 znj. Teuta Haxhiu ka dërguar kontratën e punës si mësuese në Shkollën "Zef Prenkaj-Sheremet-Gjakovë", si dhe një deklaratë ku e arsyeton gjendjen e saj në lidhje me dyshimin e mundshëm për Konfliktin të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Duke u bazuar nga faktet dhe gjendja reale si dhe në Ligjin Nr. 04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, nenin 10.2 ku thuhet se: **Gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik, zyrtari i lartë mund të ushtrojë punë nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës dhe veprimtarisë humanitare, nëse nuk parashihet ndryshe me ligje tjera.**

Konstatohet se znj. Teuta Haxhiu, Deputete e Kuvendit të Republikës së Kosovës nuk është në gjendje të Konfliktit të Interesit dhe nuk ka mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit Publik të parapar sipas Ligjit Nr. 04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, pasi që pozita e saj si Mësuese në Shkollën "Zef Prenkaj" në Sheremet të Gjakovës është punë dytësore, sekondare me dhe nuk paguhet, me rroge të plot të parapar sipas ligjeve tjera në fuqi.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

